

Shënime për pasqyrat financiare
Për vitin e mbyllur më 31 Dhjetor 2022

Shënimet mbi pasqyrat financiare në faqet vijuese janë pjesë përbërëse e këtyre pasqyrave financiare.

1. Informacione te pergjitheshme

Shoqëria "ANTIBIOTIK" sh.a, është themeluar si një shoqëri aksionere më 16 Shkurt 1996. Kapitali regjistruar është 359.227.000 dhe zotrohet nga aksioneri kryesor, ku vlen për të theksuar se aksioneri kryesor është shoqëria "ALDOSCH" shpk, e cila zoteron 97.06 % të aksioneve të kapitalit të regjistruar, ndërsa 2.94 % të aksioneve zotrohet nga aksioner mbajtës të tjerë.

Veprimtaria kryesore tregtare e shoqërisë është prodhimi dhe tregtimi farmaceutik. Për vitin ushtrimor 2022 shoqëria nuk ka zhvilluar aktivitet tregtar dhe prodhues por ka realizuar të ardhura nga dhenia me qera të ambjenteve të saj.

2. Permbledhje e politikave kontabel

Bazat e përgatitjes së pasqyrave financiare

Pasqyrat financiare janë përgatitur në përputhje me ligjin shqiptar "Për kontabilitetin dhe Pasqyrat Financiare" dhe me Standartet Kombëtare të Kontabilitetit. Ato janë përgatitur mbi bazën e parimit të kostos historike, duke kombinuar me elemente të metodave të tjera dhe parimit të drejtave të kostuara. Ato paraqiten në monedhën vendase, Lekë Shqiptar ("lekë").

Parimet kontabile më domethënëse që janë përdorur nga shoqëria, janë si më poshtë:


Njohja e të ardhurave dhe shpenzimeve

Të ardhurat dhe shpenzimet njihen sipas kontabilitetit të drejtave të konstatuara. Të ardhurat nga kryerja e shërbimeve njihen në varësi të fazës, në të cilën ndodhet kryerja e shërbimit në datën e bilancit dhe ardhurat dhe shpenzimet që lidhen me shërbimin mund të përlogaritet me besueshmëri. Të ardhurat vlerësohen me vlerën e drejtë të shumës së arkëtuar ose të arkëtueshme, duke marrë parasysh shumën e skontimeve ose rabatat e ofruara. Shpenzimet njihen atëherë kur ato sigurohen prej të tregëve dhe në të njëjtin ushtrim kontabel me të ardhurat e lidhura.

Monedhat e huaja

Transaksionet në monedhë të huaj konvertohen në lekë, me kursin zyrtar të këmbimit të Bankës në datën e kryerjes së transaksionit. Në çdo datë bilanci, zërat monetarë të bilancit të shprehur në monedhë të huaj rivlerësohen me kursin zyrtar të këmbimit të në datën e bilancit. Zërat jomonetarë, të shprehur në monedhë të huaj, maten në terma të kostos historike dhe nuk rivlerësohen. Fitimi ose humbja e pa realizuar nga ndryshimi i kurseve të këmbimit njihet në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve.

Kurset e këmbimit, të përdorura nga shoqëria për monedhat e huaja më kryesore, më 31.12.2022 janë 1 euro = 117 leke dhe 1 dollar = 105.



Tatimin mbi fitimin

Shpenzimi per tatimin mbi fitimin perfaqson shumen e tatimit per tu paguar per vitin ushtrimor. Tatim fitimi i pagueshem per vitin aktual bazohet mbi fitimin e tatueshem i cili ndryshon nga fitimi tregetar qe raportohet ne pasqyren e te ardhurave dhe shpenzimeve, sepse korrektohet nga shpenzimet e panjohura sipas legjistacionit fiskal.

Norma aktuale e tatimit mbi fitimin per vitin ushtrimor 2021 eshte 15 %.

Kërkesat për t'u arkëtuar

Kërkesat për t'u arkëtuar, të ardhurat e konstatuara dhe llogari të tjera afatshkurtra dhe afatgjata, për t'u arkëtuar në parë, regjistrohen në bilanc me kosto të amortizuar. Kostoja e amortizuar le (minus provizionet e krijuara për rënie në vlerë), kështu që kërkesat afatshkurtra regjistrohen në bilanc me vlerën e tyre neto të realizueshme (e cila raportohet, për shembull në një faturë, kontratë ose dokument tjetër).

Pasivet financiare

Huat e marra, furnitorët, shpenzimet e konstatuara dhe huamarrje të tjera afatshkurtra dhe afatgjata, për t'u shlyer në parë, në përgjithësi, mbahen me koston e amortizuar në bilanc. Kostoja e amortizuar e pasiveve financiare afatshkurtra, në përgjithësi, është e barabartë me vlerën e tyre nominale; kështu që pasivet financiare afatshkurtra mbahen në bilanc në vlerën e tyre neto të realizueshme (për shembull, të raportuar në një faturë, kontratë ose dokument tjetër).

Aktivët e qëndrueshme të trupëzuara

Aktivët afatgjata materiale (AAM-të) bazohen ne modelin e koston. Në bilanc, një element i AAM-së paraqitet me kosto minus amortizimin e akumuluar dhe ndonjë humbje të akumuluar nga zhvlerësimi. Në se vlera kontabël e një aktivi afatgjatë material rritet, si rezultat i rivlerësimit, kjo rritje kreditohet drejtpërdrejt në kapitalet e veta nën zërin "tepricë nga rivlerësimi". Nëse vlera kontabël e një aktivi afatgjatë material zvogëlohet, si rezultat i rivlerësimit, ky zvogëlim njihet si shpenzim në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve. Amortizimi është llogaritur mbi bazen e metodes lineare per ndertesat dhe mbi bazen e vleren se mbetur per pjesen tjetër te aktiveve te qendrueshme. Normat e perdorura jane ne ndertesa 5 % te vleres fillestare dhe per aktivet e tjera 20% te vleres se mbetur.

Gjendjet e inventaret


Vlerësimi ne hyrje i inventareve behet me cmimet e blerjes dhe ne rastet kur eshte e aplikueshme u shtohen kostot e shkaktuara per te sjelle inventaret ne kushte magazinimi. Gjendjet e inventarit ne pasqyrat financiare paraqiten me kostot e blerjeve te fundit te ushtrimitt qe nga drejtimi eshte çmuar si vlera neto te realizueshme.

3. Aktive financiare afatshkurtra

Kerkesat e arketueshme dhe aktive te tjera financiare, ne fillim dhe ne fund te ushtrimit kontabel 2022 si vijon:

	Ushtrimi i mbyllur 31 Dhjetor 2022	Ushtrimi i mbyllur 31 Dhjetor 2021
Aktive të tjera financiare afatshkurtra		
(i) Llogari / Kërkesa të arkëtueshme	-	-
(ii) Llogari / Kërkesa të tjera të arkëtueshme	16 480 708	22 335
(iii) Instrumente të tjera borxhi	232 369 500	229 002 540
(iv) Investime të tjera financiare		
Shuma	248 850 208	229 024 875

Shumat e paraqitura ne "Llogari / Kërkesa të tjera të arkëtueshme" perfaqesojne tepricen debitore , vlera prej 20 712 leke qe eshte vlera e tvsh-se se kreditushme vlera per 16 459 996 lek parapagim tatim fitimdhe shuma prej 235 369 500 lek eshte detyrimitt veprime te ndersjellela me ortakeve. , Huaja e marre nga ortaket eshte pa afat dhe e lire nga interesat. Nga drejtimi ajo eshte klasifikuar si afatgjate.



Aktivet Afatgjata Materiale(AAM-te)

Gjendjet dhe levizjet e aktiveve afatgjata materiale ne pasqyrat financiare paraqitet si vijon:

Gjendjet dhe levizjet	Toka	Ndertesa	Makineri dhe paisje	Aktivet te tjera afatgjata materiale	Totali
A Kosto e AAM-ve me 01.01.2022	21 540 000	290 242 412	31 771 441	1 704 873	345 258 726
Shtesat	-	-	-	-	-
Pakesimet	-	-	-	-	-
Kosto e AAM-ve 31.12.2021	21 540 000	290 242 412	31 771 441	1 704 873	345 258 726
					-
B Amortizimi AAM-ve 01.01.2022	-	164 426 990	13 434 663	1 228 941	179 090 594
Amortizimi ushtrimit	-	3 774 463	64 975	95 186	3 934 624
Amortizimi per daljet e AAM-ve	-	-	-	-	-
Amortizimi i AAM-ve 31.12.2022	-	168 201 453	13 499 638	1 324 127	183 025 218
C Zhvleresimi AAM-ve 01.01.2022	-	-	-	-	-
Shtesat	-	-	-	-	-
Pakesimet	-	-	-	-	-
Zhvleresimi AAM-ve 31.12.2022	-	-	-	-	-
D Vlera neto e AAM-ve 01.01.2022	21 540 000	125 815 422	18 637 678	325 481	166 318 581
					-
Vlera neto e AAM-ve 31.12.2022	21 540 000	122 040 959	18 572 703	230 295	162 383 957

Vlerat dhe klasifikimi ne grupe i AAM-ve te pasqyruara ne bilanc dhe ne tabelen e mesiperme jane te perputhura me te dhenat e kontabilitetit dhe te inventarizimeve fizike qe shoqeria e ka kryer ne fund te muajit dhjetor 2022.

Si politike kontabel per kontabilizimin dhe spjegimin e AAM-ve, shoqeria ka zgjedhur modelin e koston (SNK-5). Vleresimi fillestar ne momentin e marrjes ne inventar eshte bere me koston e marrjes dhe ne daten e mbylles se bilancit paraqiten me koston e tyre minus amortizimin e akumuluar dhe ndonje humbje te akumuluar nga zhvleresimi.

Shoqeria " Antibiotik " sha per vitin 2022 ka kontrat qeraje per ambientet e saja dhe ne keto kushte ka llogaritur amortizim sipas referencave ligjore ne fuqi.

Detyrime afatshkurtera-Huamarrjet

Huate dhe parapagimet afateshkurtera ne fillim dhe ne fund te ushtrimit kontabel dhjetor 2022 paraqiten si vijon:

	Ushtrimi i mbyllur 31.Dhjetor 2022	Ushtrimi i mbyllur 31 Dhjetor 2021
Huamarrjet	0	0
(i) Huatë dhe obligacionet afatshkurtra	0	0
(ii) Kthimet / ripagesat e huave afatgjata	0	0
(iii) Bono të konvertueshme	0	0
Shuma	0	0

Shoqeria nuk ka mare hua afatgjata ashtu sic dhe pasqyrohet ne pasqyren e mesiperme.

4. Detyrime afatshkurtera-Huate dhe parapagimet

Huate dhe parapagimet afatshkurtera ne fillim dhe ne fund te ushtrimit kontabel 2022 paraqiten si vijon:

	Ushtrimi i mbyllur 31 Dhjetor 2022	Ushtrimi i mbyllur 31 Dhjetor 2021
(i) Të pagueshme ndaj furnitorëve	-	-
(ii) Të pagueshme ndaj punonjësve	-	-
(iii) Detyrimet tatimore+sig.shoqerore	18 353	20 513
(iv) Hua të tjera div aksin per shpernda	5 043 468	4 318 365
(v) Parapagimet e arkëtuara	-	-
Totali 3	5 061 821	4 338 878

"Detyrimet tatimore + sig.shoqerore" perfaqesojne detyrimin e sigurimeve dhe tap per shumen 18 353 leke dhe detyrimet dividend te aksionereve te shoqerise Antibiotik sha eshte detyrim ndaj aksionereve te pakices..

Detyrime Afatgjata-Huate afatgjata

Huate afatgjate ne fillim dhe ne fund te ushtrimit kontabel 2022 paraqiten si vijon:

Huatë afatgjata	0	0
(i) Hua, bono dhe detyrime nga qeraja financiare	-	-
(ii) Bonot e konvertueshme	-	-
(iii) Huara te tjera afatgjat	-	-
Shuma	0	0

Per vitin 2022 shoqeria nuk ka huamarj.

5. Kapitalet e veta

Kapitali i rregjistruar i shoqerise, i paraqitur ne bilanc, eshte i njejte me ate te percaktuar ne statutin e shoqerise dhe vendimet e depozituara ne QKR. Me 31.12.2022 ai eshte 359.227.000 leke, i ndare ne 359.277 kuota me vlere nominale 1.000 leke /kuota. Gjate ushtrimit kontabel 2022 nuk ka rritje ose pakesim ne kapitalin e rregjistruar te shoqerise dhe ndryshime ne raportet zoterimit nga ortaket.

6. Fitimi (humbja) e vitit financiar

▪ Te ardhurat

Te ardhura e realizuara gjate ushtrimit, sipas segmenteve(kategorive) te biznesit paraqitet si vijon:

	Ushtrimi i mbyllur 31 Dhjetor 2022	Ushtrimi i mbyllur Dhjetor 2021	31
Te ardhurat nga shitja e produkteve	0	0	0
Te ardhurat nga kryerja e sherbimeve	45 310 000	48 162 580	
Te ardhurat nga shitja e mallrave	0	0	0
Te ardhurat te tjera	0	0	0
Shuma	45 310 000	48 162 580	

Gjate vitit ushtrimor shoqeria ka realizuar te ardhura nga dhenja me qera e ambjenteve te saja. Të ardhurat nga shitja e sherbimeve jane vlerësuar me vlerën e drejtë të shumës së arkëtuar .

Paraqitja ne pasqyrat financiare e te ardhurave dhe shpenzimeve eshte bere sipas natyres se tyre.

▪ **Shpenzimet e veprimtarise kryesore**

Shpenzimet, furniturave, te pasqyruara ne dokumentat justifikues, jane rregjistruar me shumate e paguara. Kostoja e punesimit, pages dhe sigurimeve shoqerore, eshte pasqyruar saktesisht si shpenzim me vleren e realizuar dhe te dokumentuar. Taksat lokale jane llogaritur dhe pasqyruar ne llogarite e ushtrimit. Sipas natyres se tyre shpenzimet e ushtrimit 2022 jane treguar ne pasqyren perkatese.

7. Shpenzimet e tatimit mbi fitimin

Shpenzimet e tatimi mbi fitimin per ushtrimin kontabel shtator 2022 dhe 2021 jane si vijon:

	Ushtrimi i mbyllur 31 Dhjetor 2022	Ushtrimi i mbyllur 31 Dhjetor 2021
I FITIMI NETO PARA TATIMIT	30 397 547	31 578 532
II SHPENZIME TE PAZBRITESHME (+)	0	0
1 Amortizime te normave fiskale	0	0
2 Shpezime pritje e dhurime te kufirit tatimor	0	0
3 Gjoha, penalitete, demshperblime	0	0
4 Provizione qe nuk njihen	0	0
5 Shpenzime pa dok. ose jo te rregullta	0	0
6 Te tjera (paga)	0	0
7 Qera	0	0
III PJESA E HUMBJES SE MBARTUR (-)	-	-
IV FITIMI (HUMBJA) TATIMORE (I+II-III)	30 397 547	31 578 532
V Shpenzimi i tatim fitimit-15%	4 559 632	4 736 780
VI FITIMI NETO I USHTRIMIT (I-V)	25 837 915	26 841 752

Per vitin 2022 ka realizuar te ardhura veten nga dhenia me qera te ambienteve te saj Keshtu qe shoqeria per vitin 2022 ka rezultuar nje fitim vetem nga qeraja , analizuar me mesiperme.

8. Transaksione te paleve te lidhura

Ne marrjen ne konsiderate te çdo transaksione dhe marredhenie te mundeshme, jo thjesht formen ligjore te tyre , shoqeria nuk ka transaksione me palet e lidhura.

Administratori

Bujar STAFUKA